

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.K. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.116/2015 datë 08.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.07.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.116/2015 datë 08.06.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktgjykimin, P.nr.116/2015 datë 08.06.2017, të akuzuarin Z.K. , e ka liruar nga akuza konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-se, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.1 të KP. Shpenzimet bien barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës. Kërkesë pasuroro-juridike nuk pati.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që kjo Gjykatë aktgjykimin e ankimuar ta anuloj ose ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën që i vihet në barrë në bazë të aktakuzës.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA./I.nr.297/17 datë 16.06.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, pasi që nuk është kontestues fakti se i akuzuari ka nënshkruar në emër të personit tjetër dhe atë të personit N.K. e kjo vërtetohet edhe nga lista e votuesve të rregullt e po ashtu nuk mohohet as nga i akuzuari ndërsa nga shkresat e lëndës nuk ekziston provë se i kanë thënë anëtarët e komisionit që të nënshkruan dhe aty ka nënshkruar. Aktgjykimi është në kundërshtim me arsyetimin ku theksohet se në bazë të provave është vërtetuar se i akuzuari nuk ka nënshkruar me dashje në vend të N.K. por të njëjtën e ka bërë nga pakujdesia për shkak të sëmundjes dhe moshës së vjetër dhe nuk ka par se ka nënshkruar në vendin tjetër.

Pretendimet ankimore të prokurorisë se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike është i pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet për faktet vendimtare të cilat si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë duke vërtetuar se në bazë të provave të administruara në shqyrtimin kryesor nuk është kontestuese se i akuzuari ka votuar në emër të personit N.K. në vendvotimin 2104/01/R, kjo u vërtetua edhe nga regjistri i votimeve ku në rubrikën nr. 4 aty ku shkruan K.N. ka nënshkruar i akuzuari Z.K. ndërsa në rubrikën nën II ku shkruan K.Z. ka nënshkrua dikush me emrin Zenel. Mirëpo gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit Z.K. i cili ka theksuar se për shkak të moshës së tij 75 vjeçare ka nënshkruar në rubrikë tjetër ndërsa mohon se ka nënshkrua në rubrikën ku është emri i tij K.Z. e kjo është vërtetu edhe me nënshkrimin e tij të cilin e ka ven në procesverbal mbi marrjen në pyetje të datës 26.06.2015 në Stacionin policor në Mitrovicë, në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të dt. 10.10.2016, në kundërshtimin e datës 07.11.2016, në ankesën e datës 12.12.2016 e ku vërtetohet se i akuzuari e ka nënshkrimin e njëjtë dhe askund nuk nënshkruan me emrin Zenel siç është e shkruar në rubrikën ku gjendej emri i tij K.Z., prandaj duke pas parasysh mbrojtjes e tij si dhe moshën e shtyrë të tij si dhe provat e administruara të cekura më lartë gjykata me të drejtë mori aktgjykim lirues për të akuzuarin në mungesë të provave.

Duke pasur parasysh këtë gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar ligjin penal kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.308/17, më 11.07.2017

Procesmbajtësja,
Eroll Gashi _____

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Have Haliti _____